



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT**

Nr.18/148 Prot

Tiranë, më 4.06.2020

**V E N D I M**  
**Nr.19, Datë 2.06.2020**

Trupa e vlerësimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e përbërë nga:

**Artur Baku**                                  **Kryesues**

**Alban Laska**                                 **Relator**

**Mirela Ujkani (Miti)**                      **Anëtar**

asistuar nga anëtari i sekretariatit teknik, Marjeta Përlala, më datë 02.06.2020 ora 10:00, në Tiranë, në Pallatin e Koncerteve, *(Ish –Pallati i Kongreseve)*, salla B, kati 0 mori në shqyrtim në seancë dëgjimore që i përket:

**SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:** **Arben Maman Saliu**, datëlindje 18.3.1962, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Standarteve Profesionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:**                                         **Vlerësimi kalimtar** i subjektit të vlerësimit.

**BAZA LIGJORE:**                                 **Ligji Nr. 12/2018**, "*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*", i ndryshuar,  
**Ligji nr. 44/2015** "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*",  
**Ligji nr. 49/2012** "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*", i ndryshuar.

## **TRUPA E VLERËSIMIT TË KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, Alban Laska, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Arben Saliu, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, shtetasi Arben Maman Saliu është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 3.6.2019 si *“Drejtor i Drejtorisë së Standarteve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”*.
3. Subjekti i vlerësimit, Arben Saliu, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 3.6.2019, nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit në përputhje me Rregulloren *“Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit”*.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga Artur Baku Kryesues, Alban Laska Relator dhe Mirela Ujkani (Miti) Anëtare.
5. Trupa e vlerësimit në përputhje me Ligjin 12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores së Brendshme të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (*miratuar me Vendimin nr.17, datë 31.5.2019 “Për Hapat Procedurale të Unifikuar gjatë Vlerësimit të Subjekteve nga Trupa e Vlerësimit”*), me Vendimin nr.1, datë 17.6.2019, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Arben Maman Saliu.
6. Relatori i çështjes, Alban Laska, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 20.6.2019 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në KJV në datën 20.6.2019 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara Ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
  - a) *vlerësimin e pasurisë; b) kontrollin e figurës; c) vlerësimin e aftësive profesionale.*
11. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ në bazë të Ligjit 12/2018 i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit, që janë:
  - *Deklarata e Pasurisë;*
  - *Deklarata për Kontrollin e Figurës;*
  - *Formulari i Vetëvlerësimit Profesional;*
 si edhe;
  - *Provat shkresore apo dokumentacione të administruara nga institucionet/organet publike dhe subjekte private në përputhje me Ligjin nr.12/2018 i ndryshuar;*
  - *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
  - *Si dhe ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*
12. Hetimi administrativ përfshiu në procesin e vlerësimit, subjektin e vlerësimit, personat e lidhur si edhe persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar.
13. Trupa e vlerësimit në datën 17.02.2020 pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Arben Saliu, me Vendimin nr.2, datë 17.02.2020, vendosi;
  - a) *Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Arben Saliu;*
  - b) *Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:*
    - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
    - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
  - c) *Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.*
14. Subjekti i rivlerësimit u njoh me relacionin paraprak, por nuk ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja.

15. Pas njohjes me raportin Komisioni, vendosi të ftojë subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore.

## II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit, Arben Saliu, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

16.1 Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të përfaqësohet vetëm. Subjekti parashitroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij. *(të pasqyruara në procesverbalin e seancës dëgjimore).*

16.2 Në fund të seancës dëgjimore datë 02.06.2020, subjekti i vlerësimit, Arben Saliu kërkoi nga Komisioni vetëm objektivitet. Në fund të seancës dëgjimore, trupa vlerësuese, u tërhoq për marrjen e vendimit, dhe e shpalli atë po në datën 2.06.2020.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

17. Subjekti i vlerësimit Arben Saliu, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

17.1 Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë gjithë fazave të hetimit.

## IV - VLERËSIMI KALIMTAR

18. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Arben Saliu ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 4.05.2018, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. \*\*\* index, viti 2018.

19. Hetimi administrativ konsistoi në:

- verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruara;
- evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

20. Komisioni ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve/huave për personat e lidhur me to dhe shtetasve të tjerë.

## IV - A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 12/2018, subjekti i vlerësimit i nënshtrohet procesit të vlerësimit kalimtar për periudhën e vlerësimit të deklaratës së pasurisë nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin

dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë. Ky deklaram fillon ditën e parë të marrëdhënies së punës.

**21.1**Subjekti i vlerësimit në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit 12/2018, ka deklaram si vijon;

**22.** Apartament banimi, me sip. 65.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Bulevardi “\*\*\*\*\*”, P. \*\*, Shk. \*, Ap. \*\* Tiranë, blerë më dt. 20.12.2002, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, privatizuar më dt. 10.2.2003. Vlera 1.600.000 lekë. Zotërimi 100%, i pa ndarë me bashkëshorten. Burimi i krijimit, kursime ndër vite nga të ardhurat për periudhën 1994 – 2002.

**a. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;**

**22.1**deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion ligjor justifikues që subjekti ka bashkëlidhur

**22.2**dokumentacioni i administruar nga Komisioni

**22.3**dokumentacioni i administruar nga deklaramet e subjektit dhënë Komisionit si përgjigje të pyetjeve gjatë procesit.

**b. Hetimi i kryer nga Komisioni në zbatim të Ligjit.**

**22.4**ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. \*\*\*\*/\*prot, dt. 30.7.2019 konfirmon se Arben Saliu dhe K.Saliu kanë të regjistruar në emrin e tyre pasuri me nr. \*/\*\*\*\*+\*\_\*\*, vol.\*\*, fq.\*\*, zk.\*\*\*\*, e llojit apartament me sip. 65.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Bulv. \*\*\*\*, Tiranë, përfutur me kontratë Shitje Apartamenti me Pagesë të Menjëhershme, me nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, dt. 20.12.2002, shitës Enti Kombëtar i Banesave dhe blerës Arben Saliu dhe K. Saliu, për apartamentin, në vlerën 1.614.127 lekë. Bashkëlidhur shkresës kartela e pasurisë dhe kontrata e shitblerjes.

**22.5**OSHEE, me shkresën nr.\*\*\*\*/\*prot, dt. 15.7.2019, konfirmon se shtetasi Arben Saliu ka lidhur kontratë energjie me nr. kontrate TR\*\*\*\*\*, në instancën e qarkut Tiranë, e cila përputhet me adresën e apartamentit të deklaram.

**22.6**UKT, me shkresën nr.\*-\*\*\*\*/\*prot, dt. 9.7.2019, konfirmon se shtetasi Arben Saliu ka lidhur kontratë ujësjellësi me nr. \*\*\*\*\*-\*, me adresë Tiranë, e cila përputhet me adresën e apartamentit të deklaram.

**22.7**Albtelecome, me shkresën nr. \*\*\*\*/\*, dt. 25.7.2019, konfirmon se shtetasi Arben Saliu ka të regjistruar numër fiks ALBtelecom 0035542\*\*\*\*\*, kontrata është telefoni fikse internet +Iptv, adresa Tiranë, e cila përputhet me adresën e apartamentit të deklaram.

**22.8**ILDKPKI, me shkresën nr.\*\*\*\*prot, dt. 21.6.2019 informon se subjekti i vlerësimit në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2003”, ka deklaram krijimin e këtij asetit, në vlerën 1.6 milion lekë.

**22.9**Subjekti i vlerësimit i pyetur gjatë procesit në pyetësorin nr. 2, nëse ka patur shpenzime për rikonstruksion apo mobilim të apartamentit, është shprehur se “Për sa i përket shpenzimeve të kryera, ato kanë qenë minimale në periudha të ndryshme.

**22.10** Subjekti ka paraqitur dokumentacion si më poshtë:

-Vërtetim hipotekor dt. 10.2.2003, në emër të Arben Saliu dhe K. Saliu, për apartament me sip. 65.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në pallatin \*\*, shkalla \*, ap. \*, Tiranë.

-Shkresë nr. \*\*\*\*, dt. 10.7.2002, nga Këshilli i Ministrave, Kryeministri, me objekt “Privatizimin e apartamentit në pronësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme”, në mbështetje të pikës 6, të vendimit nr. \*\*, dt. 17.10.1994, zoti Arben Saliu i cili gëzon statusin e të pastrehit, të përfutjës strehim nga privatizimi i apartamentit me nr. \*\*, shkalla \*, pll. \*\*, Bulv. “\*\*\*\*\*”, Tiranë.

**22.11** Nga analiza financiare e realizuar për subjektin e vlerësimit konstatohet se burim për krijimin e këtij asemi kanë shërbyer të ardhurat familjare nga paga.

**22.12** Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e Institucioneve të specializuara.**
- ✓ **Burimi financiar për krijimin këtij asemi është i ligjshëm.**
- ✓ **Subjekti ka kryer deklarim të sakt.**

**23.** Gjendje Cash (jashtë sistemit financiar bankar). Vlera 1.000.000 lekë. Zotërimi 100%.

**a. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;**

**23.1**deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion ligjor justifikues që subjekti ka bashkëlidhur

**23.2**dokumentacioni i administruar nga Komisioni

**23.3**dokumentacioni i administruar nga deklaratimet e subjektit dhënë Komisionit si përgjigje të pyetjeve gjatë procesit.

**b. Hetimi i kryer nga Komisioni në zbatim të Ligjit.**

**23.4**ISSH, me shkresën nr. \*\*\*\*\*/\*, dt. 2.7.2019 konfirmon të dhëna për kontributet për subjektin Arben Saliu, për periudhën maj 2012 – maj 2018.

**23.5**Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\*\*\*/\*, dt. 1.7.2019 konfirmon se Arben Saliu ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën 2005 – 2011.

**23.6**Tirana Bank, me shkresën nr. \*\*\*\*\*, dt. 5.7.2019 konfirmon se Arben Saliu ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën 2011 – 2018.

**23.7**Gjatë procesit subjektit i është kërkuar nga Komisioni dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat, ku ka paraqitur:

- *Vërtetim nr. \*\*\*\*\*, dt. 15.7.2019, nga Shërbimi Informativ i Shtetit, ku vërtetohet punësimi për periudhën 1997 – 2000.*
- *Vërtetim nga ISSH, ku vërtetohet punësimi i subjektit në Ministrinë e Brendshme, për periudhën maj 2000 – shtator 2008.*
- *Vërtetim nga Drejtoria e Administratës Sektori Financës, për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2003.*
- *Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për periudhën e punësimit 2005 – 2011.*
- *Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për periudhën e punësimit 2011 – maj 2018.*
- *Kopje të shkrimeve të shkruara nga subjekti Arben Saliu, të botuara në gazetën Korieri.*

**23.8**ISSH, me shkresën nr. \*\*\*\*\*/\*, dt. 2.7.2019 konfirmon të dhëna për kontributet për bashkëshorten e subjektit, me inicialet K.S, për periudhën janar 2012 – maj 2018.

**23.9**Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\*\*\*/\*, dt. 1.7.2019 konfirmon se bashkëshortja e subjektit, me inicialet K.S, ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën 2006 – 2018.

**23.10** Gjatë procesit subjektit i është kërkuar dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes, ku ka paraqitur:

- *Vërtetim nga ISSH, punëdhënës Njësia Teknika RTSH, për periudhën maj 1999 – janar 2017.*
- *Vërtetim nr. \*\*\*, dt. 25.4.2018 nga RTSH, për periudhën e punësimit shkurt 2017 – mars 2018 dhe Vërtetim nr. \*\*\*, dt. 15.7.2019 nga RTSH, për periudhën e punësimit janar 2018 – 30.6.2019.*
- *Vërtetim nr. \*\*\*/\*\*, dt. 12.12.1997 nga Shkolla 8-vjeçare “Torgut Ozal” Tiranë, ku ka qenë e punësuar si mësuese për vitin shkollor 1996 – 1997..*
- *Librezë pune e znj. K.S, ku rezulton se ka qenë e punësuar si mësuese e gjuhës angleze që prej 10.8.1987, mësuese e shkollës së mesme “Nivicë” Tepelenë deri në 19.8.1991 ku transferohet në shkollën e mesme Dukaj Tepelenë, më 1.11.1992 kalon në Drejtorinë Arsimore Tepelenë, në dt. 30.3.1993 transferohet në Tiranë.*
- *Për periudhën e emigracionit bashkëshortja e subjektit sqaron nëpërmjet një deklarate të paraqitur gjatë procesit, se:*
  - *Ka emigruar në Selanik, Greqi në Mars 1993. Këtu ka punuar mësuese e gjuhës angleze deri në qershor 1996, në dy shkolla private të mësimi të gjuhës së huaj, respektivisht “Konstandinidou” dhe “Interlingua Kallamaria” dhe ka bërë mësimë private. Si gjithë shqiptarët në vitet 90-të nuk ka mundur të pajiset me leje qëndrimi, dhe duke patur parasysh ekonominë greke tejet informale në atë kohë, nuk ka qenë e siguruar. Bashkëshorti saj, Arben Saliu ka punuar në punë të ndryshme fizike. Gjatë periudhës së bashkëjetesës në emigracion lindi vajza e tyre me inicialet R.S, më dt. 18.8.1995.*

Janë kthyer në qershor 1996. Kursimet e tyre të emigrimit konsistonin në Dhrahmi, konvertuar me kursin e vitit 1997 (10.000.000 lekë të vjetra).

Dokumentacion:

- Kopje pasaporte Republika e Shqipërisë, nr. \*\*\*\*\*, për shtetasen me inicialet K.R, dtl. 5.3.1965, ku rezulton se në dt. 26.3.1993 ka marrë vizë nga Ambasada Greke.
- Vendim nr. \*\*\*, dt. 14.4.1997, nga Gjykata e Rrethit Tiranë, kërkuese shtetasia me inicialet K.R, me objekt “Vërtetimi i faktit të lindjes së fëmijës R.Saliu nga kërkuësja, baza ligjore neni 388 K.P.Civile, ku gjykata ka vendosur pranimin e faktit të lindjes të fëmijës R.Saliu, dtl. 18.8.1993, në Selanik Greqi.

**23.11** ISSH, me shkresën nr. \*\*\*\*/\*, dt. 2.7.2019 konfirmon të dhëna për kontributet për vajzën e subjektit, me inicialet R.S, për periudhën maj 2015 – maj 2018.

**23.12** Nga analiza financiare e realizuar për subjektin e vlerësimit konstatohet se burim për krijimin e këtij aseti kanë shërbyer të ardhurat familjare nga paga, të cilat janë ligjore dhe të mjaftueshme.

**23.13** ILDKPKI, me shkresën nr.\*\*\*\*prot, dt. 21.6.2019 informon se në deklaratën e interesave private “Periodike Vjetore 2018”, subjekti ka deklaruar “*Likuiditeti në vlerën 1.000.000 lekë si gjendje cash në shtëpi është pakësuar totalisht, me destinacion, (Blerje obligacionesh në Bankën e Shqipërisë më dt. 4.6.2018 në shumën 1.000.000 lekë, nëpërmjet Raiffeisen Bank me interes 5.78%, në emër të vajzës R.Saliu, me burim gjendja cash e prindërve të saj*”.

**23.14** Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\*\*/\*prot, dt. 1.7.2019 konfirmon se vajza e subjektit, shtetasia me inicialet R.S disponon obligacione, të investuara në dt. 11.6.2018 në vlerën 1.000.000 lekë, me maturim deri në dt. 11.6.2025. Vlera prej 1.000.000 lekë është kredituar në llogarinë e pagës nga R.S në dt. 4.6.2018, me burim (kursime familjare nga babai në Policinë e Shtetit dhe mamaja në Radio Televizion).

**23.15** Institucion ligjzbatues, me shkresën nr.\*\*\*/\*prot, dt. 4.7.2019 konfirmon një transaksion bankar, kredituar në llogarinë e shtetasës R.S, në shumën 1.000.600 lekë, në bankën Raiffeisen në dt. 4.6.2018, me përshkrimin (R.S derdh të ardhura, kursime familjare, babai-Drejt e Policisë, mamaja RadioTelevizioni).

**23.16** Komisioni konstaton se ky aset i cili në momentin e dorëzimit të deklaratës ka qen si gjendje cash në shtëpi në vlerën 1.000.000 lekë, në dt. 11.6.2018 (pas dorëzimit të deklaratës) është zhvendosur me destinacion “blerje obligacionesh”.

**23.17** Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Subjekti i vlerësimit ka kryer deklarim të sakt.**
- ✓ **Burimi financiar i krijimit të vlerës 1.000.000 lekë është i justifikuar me burim të ligjshëm.**

**24.** Llogari page, në Bankën Tirana, në emër të Arben Saliu, me gjëndje në datë 4.05.2018, në vlerën 95.540 lekë. Zotërimi 100%.

**Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;**

**24.1**deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion ligjor justifikues që subjekti ka bashkëlidhur

**24.2**dokumentacioni i administruar nga Komisioni

**24.3**dokumentacioni i administruar nga deklaratimet e subjektit dhënë Komisionit si përgjigje të pyetjeve gjatë procesit.

**b. Hetimi i kryer nga Komisioni në zbatim të Ligjit.**

**24.4**Tirana Bank, me shkresën nr. \*\*\*\*\*prot, dt. 5.7.2019 konfirmon se subjekti Arben Saliu disponon llogari page, me gjendje në dt. 4.5.2018, në vlerën 92.540 lekë.

**24.5** Nga analiza financiare e realizuar për subjektin e vlerësimit konstatohet se burim për krijimin e këtij aseti kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

**24.6** Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se për këtë aset:

- ✓ *Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e bankës Tirana.*
- ✓ *Burimi financiar i krijimit të llogarisë është i ligjshëm.*

**25.** Bashkëshortja e subjektit, me inicialet K.S, ka deklaruar, llogari page, në Bankën Raiffeisen, me gjëndje në datë 4.05.2018, në vlerën 12.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i të ardhurave të ardhura nga pagat gazetare/përkthyes në RTSH.

**Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;**

**25.1** deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion ligjor justifikues që subjekti ka bashkëlidhur

**25.2** dokumentacioni i administruar nga Komisioni

**25.3** dokumentacioni i administruar nga deklaratimet e subjektit dhënë Komisionit si përgjigje të pyetjeve gjatë procesit.

**b. Hetimi i kryer nga Komisioni në zbatim të Ligjit.**

**25.4** Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\*\*/\*prot, dt. 1.7.2019 konfirmon se bashkëshortja e subjektit, shtetasia me inicialet K.S, disponon llogari page, me gjëndje në dt. 4.5.2018 në vlerën 13.952 lekë, me një diferencë prej 1952 lekë.

**25.5** Nga analiza financiare e realizuar për subjektin e vlerësimit konstatohet se burim për krijimin e këtij aseti kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

**25.6** Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se për këtë aset:

- ✓ *Përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e bankës Raiffeisen.*
- ✓ *Burimi financiar i krijimit të llogarisë është i ligjshëm.*

**26.** Vajza e subjektit me inicialet R.S, ka deklaruar, llogari page, në Bankën IntesaSanPaolo, me gjëndje në datë 4.05.2018, në vlerën 50.858 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i të ardhurave të ardhura nga paga.

**Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;**

**26.1** deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion ligjor justifikues që subjekti ka bashkëlidhur

**26.2** dokumentacioni i administruar nga Komisioni

dokumentacioni i administruar nga deklaratimet e subjektit dhënë Komisionit si përgjigje të pyetjeve gjatë procesit.

**b. Hetimi i kryer nga Komisioni në zbatim të Ligjit.**

**26.3** Banka IntesaSanPaolo, me shkresën nr. \*\*/\*\*\*\*/\*prot, dt. 9.7.2019 konfirmon se vajza e subjektit, shtetasia me inicialet R.S, disponon llogari page, me gjëndje në dt. 4.5.2018, në vlerën 50.858 lekë.

**26.4** Nga analiza financiare e realizuar për subjektin e vlerësimit konstatohet se burim për krijimin e këtij aseti kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

**26.5** Në përfundim të hetimit Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se për këtë aset:

- ✓ *Përputhet deklarimi i vajzës së subjektit me përgjigjen e bankës IntesaSanPaolo.*
- ✓ *Burimi financiar i krijimit të llogarisë është i ligjshëm.*



*Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe konfirmimeve nga institucionet e specializuara, subjekti dhe familjarët e tij, kanë krijuar aseteteve deri në dt. 4.05.2018, si më poshtë;*

<b>Asete</b>	<b>Vlera</b>
Apartament banimi me sip. 65.9 m <sup>2</sup> , në Tiranë, blerë në 20.12.2002.	Vlera 1.614.127 lekë
Gjendje cash.	Vlera 1.000.000 lekë
Llogari page, Arben Saliu, në Tirana Bank.	Vlera 92.540 lekë
Llogari page, K.Saliu, në Raiffeisen Bank.	Vlera 13.952 lekë
Llogari page, R.Saliu, në IntesaSanPaolo Bank.	Vlera 50.858 lekë

***Vlera e pasurisë së krijuar deri në datë 4.05.2018, është në vlerën bruto dhe neto 2.771.477 lekë. Subjekti nuk ka detyrime financiare të pashlyera.***

#### **TË ARDHURAVE / SHPENZIME**

Të ardhurat nga pagat e subjekti dhe familjarëve të tij, sipas dokumentacionit ligjor të paraqitur dhe institucioneve	<b>22.165.000 lekë</b>
Shpenzimet INSTAT	12.655.000 lekë
Shpenzime për qera banese	377.000 lekë
Shpenzime për udhëtime familjare jashtështetit	573.000 lekë
Shpenzime për arsimin e vajzave	280.000 lekë
Total Shpenzime	<b>13.885.000 lekë</b>
Balanca	<b>8.280.000 lekë</b>

Nga analiza financiare në vite të deklarimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë patur burim të ardhurash ligjor të mjaftueshëm për përballimin e shpenzimeve të kryera për secilin vit respektiv.

#### **IV – A; KONKLUZIONE PËR KONTROLLIN E PASURISË:**

Në perfundim të analizës së Pasurisë, nga hetimi administrativ kryesisht, duke verifikuar përputhshmërinë e deklarimeve të subjektit me dokumentacionin e administruar si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërinë nga ana financiare, ***në përputhje me piken 6 të nenit 34 të ligjit nr. 12/2018, konstatohet se;***

- a) ***deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,***
- b) ***ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;***
- c) ***nuk ka kryer fshehje të pasurisë;***
- d) ***nuk ka kryer deklaram të rremë;***
- e) ***subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.***

## V – B. KONTROLLI I FIGURËS:

1. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të tjera, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale.
2. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë (i) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar; (ii) të dhënat e mbledhura nga Komsioni i Jashtëm i Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 3, e ligjit 12/2018, i ndryshuar; (iii) verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.
3. Subjekti vlerësimit Arben Saliu, në zbatim të nenit 36, pika 2 e ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 4.05.2018, brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligjin 12/2018, *i ndryshuar*.

### I– Hetimi i kryer nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit:

4. Komisioni për të kontrolluar saktësinë e deklarimeve të subjektit të vlerësimit, në deklaratëm për kontrollin e figurës, në zbatim të nenit 37, të ligjit 12/2018, ka kryer veprime hetimore, duke kërkuar informacion zyrtar pranë institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese:
5. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën nr.\*\*\*/\*prot, dt. 4.7.2019 konfirmon një transaksion bankar, kredituar në llogarinë e shtetases R.S, në shumën 1.000.600 lekë, në bankën Raiffeisen në dt. 4.6.2018, me përshkrimin (R.S derdh të ardhura, kursime familjare, babai-Drejt e Policisë, mamaja RadioTelevizioni).
6. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën nr.\*\*\*\*prot, datë 4.7.2019 konfirmon se subjekti Arben Saliu është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli Tepër Sekret, e vlefshme nga data 19.11.2018 deri në 18.11.2023.
7. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr.\*\*\*\*prot, datë 5.8.2019, konfirmon se pas verifikimeve të kryera për z. Arben Saliu dhe lidhjes së tij familjare nuk disponon të dhëna.
8. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr.\*\*\*\*prot, datë 2.07.2019 konfirmon se pas verifikimeve të kryera për z. Arben Saliu dhe lidhjes së tij familjare nuk disponon të dhëna, materiale referuese/procedime penale në ngarkim të tyre.
9. **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale**, me shkresën nr.\*\*\*\* prot, datë 9.07.2019, konfirmon se pas verifikimeve të kryera në Sektorin e Kartotekës, në Drejtorinë e Analizës dhe Informacionit, rezulton se shtetasi Arben Saliu dhe personat e lidhur me të, nuk janë të regjistruar për veprimtari kriminale.

- 10. Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit** me shkresën nr.\*\*\* prot, datë 25.10.2019, Informon KJV - në, për vendimin nr.\*\*\*, datë 23.10.2019 e marrë nga AIDSSH për subjektin e vlerësimit Arben Saliu.
- 10.1** Në këtë vendim AIDSSH ka vendosur:- *Të informojë Institucionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, se nga verifikimet e kryera deri tani për shtetasin Arben Saliu nuk rezulton të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpuntor ose i favorizuar nga ish – Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit 12/2018, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Doklumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*
- 11. Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit**, me shkresën nr.\*\*\*prot, datë 16.8.2019 nëpërmjet verifikimeve në TIMS na konfirmon të gjitha hyrjet-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë për periudhën 1.1.2016-14.8.2019 për subjektin dhe personat e lidhur me të.  
*KJV komunikoi me shkresë me DPSHTRR për verifikimin e targave të konfirmuara nga TIMS.*
- 11.1 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Regjistrimit të mjeteve**, me shkresën nr.\*\*\*prot, datë 2.10.2019 me kërkesën e KJV ka verifikuar të gjitha targat e konfirmuara nga sistemi TIMS për të gjitha hyrjet-daljet nga Territori i Republikës së Shqipërisë.
- 11.2** Nga verifikimi i targave dhe personave përgjegjës të këtyre automjeteve rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë udhëtuar apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.
- 12. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore**, me shkresën nr.\*\*\*prot, datë 22.11.2019 dhe DT. 25.11.2019 konfirmon se nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë; Kukës, Dibër, Elbasan, Shkodër, Pukë, Përmet, Kurbin, Gjirokatër, Kavajë, Tiranë, Durrës, Korçë, Tropojë, Mat, Lezhë, Berat, Krujë, Vlorë, Pogradec, Lushnje, Sarandë dhe Fier, konfirmojnë se për shtetasin Arben Saliu, nuk është nxjerr urdhër ndalimi, nuk ka kërkuar masa për sigurim personal, nuk është marrë në cilësi e të pandehurit apo personit nën hetim, nuk ka pasur regjistrim të veprave penale dhe nuk ka urdhër ndërkombëtar të ndalimi.
- 13. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda**, me shkresën nr.\*\*\*prot, datë 18.11.2019 dhe datë 2.10.2019 konfirmon se ndaj shtetasit Arben Saliu, nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.
- 14. Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamenti për Shërbimet Mbështetëse**, me shkresën nr.\*\*\*prot, datë 17.10.2019, ka përcjellë formularin e vetdeklarimit bazuar në kërkesën e KJV për vënie në dispozicion të formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 i ndryshuar dhe Vendimit të Kuvendit 17/2016 të dalë në zbatim të tij për subjektin Arben Saliu.
- 14.1** Komisioni fillimisht kreu verifikimin formal të këtij formulari, duke krahasur atë edhe me vërtetësinë e të dhënave të plotësuara në formularin e kontrollit të figurës si dhe më tej në zbatim të përcaktimeve të ligjit specifik 138/2015.
- 14.2** Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kriterëve dhe kushteve të ligjit 138/2015.
- 14.3** Veprimet e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit janë kryer në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe orientimeve të saj.

- 14.4 Për sa më sipër, rezulton se deri më tani nuk ka rrethana, ngjarje apo të dhëna/indicje për të cilat të diponohen informacione në ngarkim të subjektit, për të cilin duhen nisur hetime të thelluara nga organet ligjzbatuese.
15. **Avokati i Popullit**, me shkresën nr.\*\*\*\*prot, datë 7.8.2019, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin Arben Saliu.
16. **Drejtoria Përgjithshme e Burgjeve**, nëpërmjet postës elektronike, në datë 10.7.2019 ka konfirmuar se subjekti Arben Saliu rezulton i padënuar.
17. Bazuar në ligjin 12/2018, neni 38, pika 2, subjekti i është nënshtruar një **Vlerësimi Psikologjik**. Në datë 11.02.2020 ka ardhur raporti i vlerësimit psikologjik ku në bazë të rezultateve ka rezultuar se subjekti i vlerësimit Arben Saliu:
- *aktualisht nuk konstatohen problem të shëndetit mendor të subjektit. Vlerësohet se shfaqet psikologjikisht I aftë të funksionojë në aspektin okupacional, ndërpersonal, social dhe familjar.*
  - *Shfaq aftësinë të mira të lidërshipt dhe empatisë ndaj punonjësve. paraqet marrëdhënie të stabilizuara personale dhe ndërpersonale;*
  - *nuk paraqet problematika të personalitetit, që mund të çenojnë realizimin e detyrave dhe aktivitetin e tij në tërësi, si dhe shfaq stabilitet emocional në përditshmërinë e tij.*
18. Pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit të vlerësimit Arben Saliu, për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

#### **Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:**

Komisioni pas një hetim të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Arben Saliu, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, (ii) analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, testit psikologjik, arriti në konkluzionin se:

#### **Subjekti i vlerësimit Arben Maman Saliu:**

- ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- nuk ka informacione në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtashme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale;*
- punonjësi është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës*

## **VI – C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE:**

- Objekt i raportit të vlerësimit të aftësive profesionale është: (i) vlerësimi i aftësive profesionale; (ii) vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit; (iii), respektimi i rregullave të etikës, si dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti i vlerësimit si punonjës në Policinë e Shtetit, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, dhe legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

2. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në tre elementë (i) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar; (ii) të dhënat e mbledhura nga Komsioni i Jashtëm i Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 3, e ligjit 12/2018, i ndryshuar; (iii) tre dokumente të paraqitura nga subjekti i vlerësimit, në zbatim të nenit 46, pika 3, dhe 44, pika 2, e ligjit 12/2018, i ndryshuar, të cilët janë përgatitur në ushtrim të detyrave funksionale të subjektit të vlerësimit si punonjës në Policinë e Shtetit.

### **I - Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:**

3. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Drejtues i Parë, Arben Maman Saliu, më datë 4.05.2018, ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (*formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*), sipas përcaktimeve të 44 pika 1, të ligjit Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit kalimtar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit ka ushtruar detyrën e “*Drejtorit në Drejtorinë e Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit*”.
4. Neni 44, pika 2 dhe 3 e ligjit 12/2018, përcaktojnë se: “*Periodha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 7 vjet*”.

### **II - Vlerësimi i nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit:**

5. Në lidhje me Vlerësimin e nivelit të arsimimit të subjektit të vlerësimit rezultojnë se:
  - 1977-1981, Shkolla e Mesme e Mjeshtërisë Sportive, Tiranë.
  - 1982-20.8.1987, Fakulteti Histori Filologji, Universiteti “Enver Hoxha”, Tiranë.
  - 1.10.1991-29.2.1992, Shkolla e Lartë e MP Brendshme, Oficer i Policisë Kriminale (kurs), Tiranë.
  - 1998-22.7.2002, Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”, Specialist i lartë Policie, Tiranë.
  - 2008-31.1.2012, Fakulteti i Drejtësisë, Shkolla e Lartë jo Publike “Justicia”, Bachelor në Drejtësi, Tiranë.
6. Nga sa më sipër, në kuptim të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, nenit 124, pika 2, e ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i vlerësimi përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron dhe gradën policore që mban si punonjës i Policisë së Shtetit.

### **III - Procesi i fitimi të gradës:**

7. Neni 45, pika 3, shkronja (c), e ligjit 12/2018, përcakton se: *objekt i vlerësimit të afësive profesionale janë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.*

#### **7.1 Fitimi i gradës “Oficer”**

Nga aktet e administruara kontaktohet se:

Oficer, sipas urdhrit, nr.\*\*\*\*, datë 5.10.1991, për periudhën 01.10.1991 deri më 15.9.1992;

#### **7.2 Fitimi i gradës “Major”**

Nga aktet e administruara kontatohet se:

Major, sipas urdhrit, nr.\*\*\*\*, datë 4.12.1997, për periudhën 16.11.1997 deri më 1.02.1998;

#### **7.3 Fitimi i gradës “Kolonel”**

Nga aktet e administruara kontatohet se:

Kolonel, sipas urdhrit, nr.\*\*\*, datë 16.02.1998, për periudhën 1.02.1998 deri më 10.05.2000;

Kolonel, sipas urdhrit, nr.\*\*\*\*, datë 9.05.2000, për periudhën 10.05.2000 deri më 1.07.2003;

#### **7.4 Fitimi i gradës “K/Komisar”**

Nga aktet e administruara kontatohet se:

Kryekomisar, sipas urdhrit, nr.\*\*\*\*, datë 1.07.2003, për periudhën 1.07.2000 deri më 30.09.2005;

#### **7.5 Fitimi i gradës “Drejtues”**

Nga aktet e administruara kontatohet se:

Drejtues, sipas urdhrit, nr.\*\*\*\*/\*, datë 18.10.2010, për periudhën 20.10.2010 e në vazhdim.

**7.6** Komisioni konstaton se dhënia dhe fitimi i gradave është bërë në përputhje me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akte nënligjore në fuqi.

### **IV- Vlerësimi i tre dokumenteve të përgatitura nga subjekti i vlerësimit:**

**8.** Subjekti i vlerësimit, në zbatim të nenit 46, pika 3, dhe 44, pika 2, e ligjit 12/2018, ka depozituar tre dokumenteve zyrtare të përgatitura në ushtrim të detyrave funksionale si punonjës në Policinë e Shtetit, dhe konkretisht:

**8.1** Analiza e punës së drejtorisë së standarteve profesionale për 6 mujorin e parë 2019”, nr. 32 prot., datë 15.07.2019;

**8.2** “Observacione mbi Raport –Inspektimin e kryer në Sektorin e Hetimit Disiplinor, në Drejtorinë e Standarteve Profesionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, nr. 1368/3 prot., datë 4.10.2018;

**8.3** “Plan pune mujor drejtoria e Standarteve Profesionale”, Qershor 2019.

#### ***Nga analiza e tre dokumenteve të përgatitura nga subjekti i vlerësimit konstatohet se:***

**8.4** *Subjekti i vlerësimit ka njohuri të thelluara mbi legjislacionin që normon kuadrin ligjor të Policisë së Shtetit, si dhe akteve nënligjore në fuqi, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e Policisë së Shtetit.*

**8.5** *Dokumentet e përgatitura nga subjekti i vlerësimit janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore që normojnë kuadrin ligjor për Policinë e Shtetit;*

**8.6** *Dokumentat e përgatitura nga subjekti i vlerësimit janë të qarta, të kuptueshme dhe të strukturuar logjikisht;*

### **V- Respektimit i rregullave të etikës:**

**9.** Nga verifikimi i dosjes së personelit ardhur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit, (vlerësimet e eprorëve ndër vite), arrihet në konkluzinin se :

- 9.1** subjekti është vlerësuar me pikë maksimale për integritetin, gjithëpërfshirjen, menaxhimin, përqëndrimin, vullnetin, profesionalizmin në kryerjen e detyrave; komunikimin efektiv, qëndrimin konstruktiv, dhe paanshmërinë;
- 9.2** punon në grup, ndërton marrëdhënie të mira dhe korrekte me kolegët dhe qytetarët;
- 9.3** është korrekt me detyrën që kryen, korrekt me vartësit, kolegët dhe eprorët;
- 9.4** tregon objektivitet, korrektësi dhe përpikmëri në kryerjen e detyrave të caktuara;
- 9.5** Më datë 9.01.2003, me nr. dekreti\*\*\*\*, Kolonel Arben Maman Saliu i është dhënë Medalje Mirënjohje “Për organizim e drejtim cilësor të punës, për profesionalizëm dhe përkushtim në kryerjen e detyrës”, nga Presidenti i Republikës.
- 9.6** Institucioni i Avokatit të Popullit, shkresën nr.\*\*\* prot, datë 28.6. 2019; informon Komisionin se pas verifikimeve të kryera përmes shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në institucion, për subjektin e vlerësimit nuk rezulton të ketë pasur ankesa të trajtuara me kërkesë të shtetasve, apo hetime të nisura kryesisht për shkelje ligjore;

### **Në përfundim të hetimit të kryer për vlerësimin e aftësive profesionale:**

Komisioni pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësim e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, analizimin e tre dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti, verifikimin e procesit të fitimit të gradave ndër vite, përputhjen e gradës me pozicionin e punës, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se,

### **Subjekti i vlerësimit Arben Saliu:**

- a) është i aftë, duke treguar cilësi të larta në punë*
- b) aftësi në zbatim të përshkrimeve të punës, të përcaktuara për atë funksion;*
- c) ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut;*
- d) është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme;*

### **V- Konkluzione Përfundimtare:**

Trupa vlerësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatorit të çështjes, parashtrimet me shkrim të depozituar nga subjekti i vlerësimit, pasi dëgjoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 2.06.2020, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Arben Maman Saliu, në përputhje me nenin 60 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;*

**PËR KËTO ARSYE**

Trupa Vlerësues e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, bazuar në pikën 7, 8, të nenit 56, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

#### **V E N D O S I:**

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit *Arben Maman Salii, me funksion Drejtor i Standarteve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*
- 2.** Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
- 3.** Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit 12/2018, të ndryshuar.
- 4.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- 5.** *Ky vendim u shpall sot datë 2.06.2020 në Tiranë.*

#### **TRUPA E VLERËSIMIT**

**Artur Baku**  
**Kryesues**

**Alban Laska**  
**Relator**

**Mirela Ujkani (Miti)**  
**Anëtar**